

SISTEMI SHENDETËSOR NË SLLOVENI: SHERBIMET PËR GRATË

ALBISHQ



SIGURIMI SHENDETËSOR

Për një qendrim më të gjatë në Slloveni ju duhet ta keni lejen e qendrimit të përhershëm ose të përkohshëm. Këtë mund ti rregulloni në Zyrën e të huajve apo në Njësi administrative.

Për shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore është e nevojshme ta rregulloni sigurimin e detyrueshëm shëndetësor.

Informacionet rreth kësaj mund ti merrni në dhjet njësi të Institutit të sigurimeve shëndetësore të Sllovenisë të cilat ndodhen në të gjithë shtetin.

www.zzzs.si/zzzs/imenik.nsf

Juve mund të ju siguron:

1. një anëtar i familjes i cili është i punësuar,
2. punëdhënsi juaj,
3. komuna, ne rast se ju nuk keni të ardhura financiare, ose të
4. siguroheni vetë – në këtë rast duhet të paguani një kontribut të rregullt mujorë.

Pas rregullimit të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor juve do t'ju vijë në adresen tuaj përmes postës kartela e sigurimit shëndetësor.



Sigurimi i detyrueshëm siguron disa shërbime themelore shëndetësore. Shërbime të tjera të kujdesit shëndetësor kërkojnë sigurim shtesë shëndetësor, përndryshe ato shërbime jeni të detyruar ti paguani vet.



ZGJEDHJA E MJEKUT

Në qendrën shëndetësore më të afërt ju mund të zgjedhni:

- mjekun e përgjithshëm/familjar
- stomatologun
- për femiun: pediatër (ambulanta pediatrike)
- për gratë: gjinekologu (ambulanta gjinekologjike).

Zgjedhjen mund ta bëni në mes të mjekëve të rregullt dhe atyre me koncesion (privat) të cilët janë pjesë e shëndetit publik. Mjekët e zgjedhur janë në dispozicion pa udhëzim por gjithmonë me termin paraprak.

Tek gjinekologu shkoni për:

- »gjërat e grave« - këshilla, diagnostikim, shërim;
- Përcjellje të shtatzanisë;
- Këshilla dhe mbrojtje nga shtatzania e padëshiruar – përsëmbull: barna kundër shtatzanisë, spirala ...
- Këshilla dhe udhëzim në rast të shtatzanisë të padëshiruar;
- Zbulimin e hershëm të kancerit në qafën e mitrës.

Për probleme shëndetësore të tjera ju duhet ta vizitoni mjekun familjar/të përgjithshëm.

112

Në rast të rrezikut për jetë telefonojeni EMERGJENCEN në numrin e telefonit 112.



TRAJTIM I GRUAS SHTATZËNË

Në rast se jeni shtatzane ju duhet të bëni termin tek gjinekologu juaj.

Gjatë gjithë shtatzanisë ju do të keni rreth:

- 10 vizita,
- 2 vizita me ultraza,
- Analiza të ndryshme në laborator.

Ju këshillojmë ta vizitoni PREGADITJEN PËR LINDJE DHE KUJDESIN PRINDERORË, vetë ose sëbashku me partnerin tuaj.

Në takimet të cilat mbahen në grup ju do të merrni informata dhe aftësi rreth:

- Shtatzanisë,
- Lindjes,
- Kujdesit ndaj të posalindurit,
- Gjdhënjes,
- Kujdesitë për shëndet.

Pregaditja për lindje dhe kujdesin prindërorë organizohet në qendrat shëndetësore dhe në disa spitale të lindjes. Pjesëmarrja është pa pagesë. Interesohuni nëse e tilla është në dispozicion në gjuhën tuaj dhe nëse është në dispozicion në mënyrë individuale.



LINDJA

Ju mund të lindni në cilin do nga 14 spitale të lindjes.

Gjatë lindjes mund të ju shoqërojë njeriu që e zgjedhni vetë (zakonisht ai përsos është partneri/burri).



Në momentin e nisjes drejt spitalit të lindjes ju duhet ti keni me vetë këto gjëra: të gjithë dokumentacionin shëndetësor rreth shtatzanisë (librin e nënës) dhe udhëzimin të cilin jua jep gjinekologu.

Gruaja e cila ka kaluar një lindje pa komplikacione qëndron në spitalin e lindjes dy deri tri ditë.

Foshnjen në spitalin e lindjes do ta kontrollojë pediatri, ata gjithashtu kryejn disa hetime parandaluese dhe nderhyrje tek i posalinduri.



SHERBIMET SHENDETËSORE PAS LINDJES

Vizitat e infermierës patronazhe në shtëpin tuaj

Pas lëshimit nga spitali i lindjes juve do t'ju vizitojë infermierja patronazhe në shtëpin tuaj. Deri tek mosha një vjeqare e fëmiut ajo do ti bëjë gjithsej 8 vizita.

Shërbimin patronazh në qendrën shëndetësore më të afërt rreth lëshimit tuaj sipas rregullave duhet ta lajmëron spitali ku ju keni lindur. Por ne ju këshillojmë që në ditën pas lëshimit nga spitali i lindjes ata t'i lajmëroni dhe vetë.

Kontrolla pas lindjes tek gjinekologu

6 javë pas lindjes është e parapame vizita tek gjinekologu juaj i zgjedhur.

Për vizitën bëni termin sa më shpejt.



PEDIATER

Zgjedhni mjekun pediatër për fëmiun tuaj gjatë fundit të shtatzanisë apo sa më shpejtë pas lindjes.

Këtë mund ta bëni në qendrën shëndetësore ose ta kërkonin pediatriin i cili punon në shëndetin publik dhe që është me koncesion.

Pediateri:

- I kryen kontrollat sistematike parandaluese me të cilat përcjell rritjen dhe zhvillimin e fëmiut,
- Kryen vaksinimin e planifikuar,
- Diagnostikoni dhe shëron sëmundjet e fëmijërisë.

Kontrolla e parë sistematike dhe parandaluese është e planifikuar në muajin e parë të moshës së fëmiut.

Për këtë kontrollë duhet të bëni termin.

Prevedla: Adelina Ahmetaj Cafeshi
Prevod gradiva v albanščino sofinancirata Republika Slovenija in Evropska unija iz Evropskega socialnega sklada.



Nacionalni inštitut za javno zdravje



REPUBLIKA SLOVENIJA
MINISTRSTVO ZA ZDRAVJE



EVROPSKA UNIJA
EVROPSKI SOCIALNI SKLAD